

## **AKT – THEMELIMI**

### **Per themelimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar Media Union sh. p. k**

Sot me date 5. 12. 2000, ne Tirane, une i neneshkruari Edmond Leka, i biri i Vlashit dhe Margarites, i lindur me 17. 05. 1963 ne Tirane, me banim ne Tirane, Rr “ Lidhja e Prizrenit”, Pallati 12, Ap 10, Nr. Pas. 0126431 vendosa me vullnetin tim te lire per sa me poshte vijon:

#### **Neni 1**

Krijohet Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin "MEDIA UNION" sh. p.k.

#### **Neni 2**

Kohezgjatja e Shoqerise kufizohet ne nje afat prej 20 -vjetesh dhe mund te zgjatet me vendim te ortakut te vetem.

#### **Neni 3**

Selia e Shoqerise ndodhet ne Rruga Myslym Shyri, Pallati 55/1 (shtesa) Tirane.


#### **Neni 4**

Objekti i Shoqerise eshte:

1. Botimi, prodhimi dhe shperndarja e revistave, gazetave, librave dhe materialeve te tjera te lejuara me ligj.
2. Organizimi i te gjitha aktiviteteve kulturore, artistike, sportive dhe lojrave te ndryshme te lejuara me ligj.
3. Kryerja e aktivitetit te marketingut, te agjentit komisioner apo te perfaqesuesit per firmat e ndryshme te vendit apo te huaja.
4. Konsulence ne fushen ekonomike dhe financiare.
5. Dhe ne pergjithesi te gjitha operacionet industriale, tregtare, financiare, civile, mobiliare apo imobiliare, qe kane lidhje direkte apo indirekte me objektin social si dhe me objekte te ngjashme apo te lidhura me te.

#### **Neni 5**



Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 30.000 USD dhe eshte i ndare ne 100 kuota prej 300 USD sejcila. Ky kapital eshte neneshkruar teresisht nga ortaku i vetem.

#### Neni 6

Shoqeria konsiderohet e krijuar ne perputhje me dispozitat e kesaj kontrate, te statutit qe miratohet dhe firmoset nga ortaku i vetem dhe qe i bashkelidhet kesaj kontrate si dhe legjislacionit shqiptar.

#### Neni 7

Ne perputhje me nenin 10 te Statutit te Shoqerise, themeluesi vendos qe Shoqeria te administrohet per nje periudhe kohe te papercaktuar nga nje administrator i vetem. Ne kete funksion zgjidhet

Znj. Irma Shagla, e bija e Sotiraqit, lindur ne Korce, me 29/10/1960, banuese ne tirane, rruga L.Prizrenit, P.4, Sh.1, Ap.5, e pranon kete detyre dhe deklarone se nuk ka probleme te papajtueshmerise te parashikuar nga legjislacioni shqiptar

#### Neni 8

Ortaku i vetem i delegon administratorit te vetem te drejten per ndjekjen dhe plotesimin e praktikës per themelimin ligjor te Shoqerise si dhe kryerjes se ndryshimeve apo shtesave ne kete akt dhe ne statut, qe mund te kerkohen nga autoritetet kompetente shqiptare deri ne krijimin e Shoqerise.


#### Neni 10

Viti i pare financiar mbyllet me 31 Dhjetor 2001.

Tirane, me 06/12/2000

**Ortaku i vetem:**

**EDMOND LEKA**

*Edmond Leke*  




REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
Nr. .... 2273. Rep

### VERTETIM

Ne Tirane, sot me date 11.12.2000 para meje noterit G.Shkodra, u paraqit personalisht z Edmond Leka, i biri i Vlashit, lindur ne Tirane, me 17.05.1963, banues ne Tirane, rruga L.Prizerenit, P.12, Ap.10, ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise MEDIA UNION shpk, i cila me kerkoi vertetimin e nenshkrimit te tij ne aktin bashkengjitur dhe une noteri pasi u binda per identitetin e tij nga pasaporta n. 0126431 e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERI

**S T A T U T I**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**MEDIA UNION**

Bazuar ne ligjin "Per Shoqerite Tregetare" Nr. 7638, date 19.11.1992 dhe mbeshtetur ne kontraten e themelimit te dates 22.01.1999 une i nenshkruari: Edmond Leka, i biri i Vlashit dhe Margarites, i lindur me 17. 05. 1963 ne Tirane, me banim ne Tirane, Rr " Lidhja e Prizrenit", Pallati 12, Ap 10, Nr. Pas. 0126431 vendosa te aprovoj statutin e meposhtem:

Emertimi, Selia, Kohezgjatja

Neni 1

Krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar: "MEDIA UNION" sh. p.k.

Neni 2

Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen Rruga Myslym Shyri, Pallati 55/1 (shitesa) Tirane.


Mund te ndertohen qendra dytesore dhe filiale te shperndara ne te gjithe territorin e Shtetit Shqiptar

Neni 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte e kufizuar ne nje afat prej 20 vjetesh dhe mund te zgjatet perseri me vendim te mare nga ortaku i vetem.

Neni 4

Vendbanimi ligjor i ortakut, persa i perket raporteve me Shoqerine, eshte ai qe rezulton ne librin e ortakeve.



II. Objekti

Neni 5

Shoqeria ka per objekt:

- 1- Botimi, prodhimi dhe shperndarja e revistave, gazetave, librave dhe materialeve te tjera te lejuara me ligj.
- 2- Organizimi i te gjitha aktiviteteve kulturore, artistike, sportive dhe lojrave te ndryshme te lejuara me ligj.
- 3- Kryerja e aktivitetit te marketingut, te agjentit komisioner apo te perfaqesuesit per firmat e ndryshme te vendit apo te huaja.
- 4- Konsulence ne fushen ekonomike dhe financiare.
- 5- Dhe ne pergjithesi te gjitha operacionet industriale, tregtare, financiare, civile, mobiliare apo imobiliare, qe kane lidhje direkte apo indirekte me objektin social si dhe me objekte te ngjashme apo te lidhura me te.

Neni 6

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimit qe do te marre ortaku i vetem.

III. Kapitali Themeltar

Neni 7


Kapitali themeltar eshte fiksuar 30.000 USD, i ndare ne 100 kuota me nga 300 USD secila.


Neni 8

Kuotat jane te transferueshme me akt ndermjet te gjalleve, me kusht qe ky transferim te jete i miratuar nga ortaku i vetem. Ky transferim duhet te evidentohet me akt noterial.

Neni 9

Ortaku i vetem mund te vendose per zvogelimin e kapitalit themeltar te





Shoqëria, ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi.

#### IV. Administrimi

##### Neni 10

Shoqëria administrohet nga administratori i vetem, qe mund te jete edhe jo ortak, i zgjedhur nga ortaku i vetem per nje kohe te pakufizuar, me perjashtim te revokimit te tij nga ortaku i vetem me te pakten tre muaj njoftim paraprak.

##### Neni 11

Administratori i vetem ka pushtet te plote per drejtimin e Shoqëria dhe ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet qe i gjykon te arsyeshme per arritjen e objektivave te Shoqëria, me perjashtim te atyre qe ligji shprehimisht ia rezervon ortakut te vetem.

##### Neni 12

Administratori i vetem perfaqëson Shoqëria ne lidhje me te tretet si dhe ne organet e drejtesise. Ai ka te drejte te ndermarre veprime ne instancat administrative dhe gjyqësore.

##### Neni 13

Punesimi i personave te trete do te behet ne baze te kontrates individuale te punes. Per te gjitha problemet qe nuk parashikohen ne kontraten individuale te punes, do te zbatohet legjislacioni shqiptar i punes.


#### V. Bilanci dhe Fitimi

##### Neni 14

Viti financiar mbyllet me 31 Dhjetor te çdo viti.

##### Neni 15

Ne mbylljen e vitit financiar administratori i vetem ndjek hartimin e llogarive vjetore, ne perputhje me dispozitat ligjore. Ortaku i vetem miraton bilancet, nese



eshte e nevojshme, pas raportit te revizoreve, te kontabilitetit, brenda gjashte muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 16

Fitimi neto, pas zbritjes se nje shume jo me te vogel se 5 % per rezerven ligjore, i shtohet kapitalit, me perjashtim te rastit kur ortaku i vetem vendos qe ai te perdoret per rezerven e jashtezakonshme ose per qellime te tjera ne favor te administratorit, ose te mbartet pjeserisht apo teresisht ne vitin e ardhshem financiar.

Neni 17

Pagesa e dividendeve behet nga administratori i vetem brenda afatit te caktuar prej tij, prane Bankes perkatese.

Neni 18

Dividentet qe nuk terhiqen brenda nje periudhe 5-vjeçare nga data kur behen te pagueshme, kalojne ne favor te Shoqerise.

VI. Prishja e Shoqerise

Neni 19

Ne rast prishje te Shoqerise, ortaku i vetem vendos, ne çdo kohe dhe ne çdo rast, modalitetet per likuidimin dhe emeron nje apo shume likuidatore si dhe kompetencat e tyre.

Neni 20

Per çka nuk eshte parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen normat e pergjithshme te Kodit Civil, si dhe ligjet e veçanta qe u perkasin Shoqerive.

Tirane, me 06/12/2000

**ORTAKU I VETEM**

**EDMOND LEKA**

*Edmond Leke*  




REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
Nr. ... 2024 Rep

### VERTETIM

Ne Tirane, sot me date 11.12.2000 para meje noterit G.Shkodra, u paraqit personalisht z Edmond Leka, i biri i Vlashit, lindur ne Tirane, me 17.05.1963, banues ne Tirane, rruga L.Prizerenit, P.12, Ap.10, ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise MEDIA UNION shpk, i cila me kerkoi vertetimin e nenshkrimit te tij ne aktin bashkengjitur dhe une noteri pasi u binda per identitetin e tij nga pasaporta n. 0126431 e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERI